



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 09.06.2022

Numri i vrojtimit të lejes:

07 Nr.256/350-29013

- Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së z. Betim Basha nga Sllapuzhani, Komuna Suharekë , 07 Nr. 350-29013 të datës 17.05.2022, në bazë të nenit 5, 14 dhe 21 të Ligjit të ndërtimit Nr. 04/L-110 dt. 31 Maj 2012, nenit 56 dhe 57 të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve 01Nr.-16-423 dt. 26.01.2011, nenit 8 alinea 8.9 pika 8.9.1 të Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015, nenit 5 pika 5.2 al. 5.2.2, nenit 6, 7, 8 pika 8.3, nenit 9 al. 9.19.7, nenit 11, 12, 13, 14, 15 dhe 17 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private 01-Nr.16-4719 të datës 30.06.2016 si dhe Procesverbalit 07Nr.222/350-29013 të datës 30.05.2022, nenit 44, 47, 48 dhe 125 të LPPA -së bie këtë:

P Ë L Q I M

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Betim Basha - Sllapuzhan.	Nr. Personal	
Adresa:	“ Betim Basha ”B.I. Rr.“ Brigada-123 “ Suharekë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim-për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e ombrellave dhe tavolinave lëvizëse.

Përshkrimi:

I LEJOHET - investuesit - z. **Betim Basha** , nga Sllapuzhani, Komuna Suharekë, vendosja e tavolinave dhe ombrellave **lëvizëse** ose **mbulojës lëvizëse** të fiksuar për objekti për hijezim të lokalit dhe platos para lokalit të tij afarist **“Betim Basha” B.I.** , si dhe shfrytëzimin e hapsirës publike në një sipërfaqe prej **20m²** dhe përtej oazës së gjelbëruar ekzistuese - sipërfaqe prej **20.00m²** - në sheshin “Fadil Vata”, në parcelën kadastrale Nr. 2784-1, pronë shoqërore, kom. kad. Suharekë, në rrugën “Brigada-123” në Suharekë.

Për shkak se lokali afarist posedon një hapësirë jo shumë të madhe, atëherë hapësira e mbulojës së platosë do të shfrytëzohet si separe gjegjësisht si kënd për shërbimeve afariste hoteliere.

Vendosja e tavolinave, mbuloja e platosë me mbulesë lëvizëse ose ombrella, si dhe shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës shoqërore - hapsirës publike - **lejohe me karakter të përkohshëm sezonal** dhe vlen nga data **27.05.2022** deri më **31.10.2022** , me mundësi të vazhdimit pas shqyrtimit të rrethanave të reja të krijuara dhe dispozitave tjera ligjore .

Shfrytëzuesi do të shfrytëzojë platonë në një sipërfaqe prej **20m²** - para lokalit dhe përtej oazës së gjelbëruar ekzistuese - sipërfaqe prej **20.00m²**, për të cilën do të paguaj sipas Rregullores së Komunës së Suharekës për shfrytëzimin e pasurisë - tokës shoqërore, dhe atë **3 euro për m² në muaj**, shuma për pagesë prej **27.05.2022** deri me **31.10.2022** është gjithsejtë : **615,48 Euro**.

Investuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër.

Gjithashtu hapësira e cila i jepet në shfrytëzim nuk lejohet të kufizohet (rrethohet) .

Trotuari duhet të jetë i lirë dmth. shfrytëzimi i sipërfaqes së lejuar duhet të shfrytëzohet në atë mënyrë që të mos e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve (këmbësorëve) në trotuar .

Për nevoja më të mëdha të realizimit të planit urbanistik të asaj pjese të Suharekës , ku lejohet shfrytëzimi i kësaj hapësire për vendosjen e përkohshme të objekteve të cituara më lartë , investuesit edhe para skadimit të afatit të caktuar me këtë Pëlqim mundet të i bihet Aktvendimi për mënjanimin e objekteve në fjalë, pa kurrfarë kompensimi nga ky Organ e në shpenzime të vet investuesit.

Me rastin e festave kombëtare, tubimeve dhe për nevoja të tjera nga drejtoria e Urbanizmit - jeni të obliguar që objektet e cekura më lartë ti menjanoni për një kohë të caktuar.

Nëse ka ankesa nga ana e fqinjëve përshkak të zhurmës apo pengesave tjera të arsyeshme të banorëve për rreth, atëherë do të merren masa konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Investuesi është i obliguar që më së paku 30 ditë para skadimit të afatit të këtij Pëlqimi të parashtroi kërkesë të re për zgjatjen e afatit për shfrytëzimin e hapsirës publike .

Për mos kryerje të punëve sipas këtij Pëlqimi , inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj.

Ky Pëlqim pushon të vlej nëse investuesi nuk i vendos këto brenda afatit të cituar në këtë Pëlqim.

A r s y e t i m

Duke e shqyrtuar kërkesën e investuesit z. **Betim Basha**, nga Sllapuzhani, Komuna Suharekë, ky Organ konstatoi se kërkesa është e arsyeshme dhe se të përmendurit mundet të i lejohet vendosja e tavolinave dhe ombrellave lëvizëse ose **mbuloja lëvizëse** e fiksuar për objekti si dhe shfrytëzimi i hapsirës publike - tokës shoqërore në një sipërfaqe prej **20m²** - para lokalit dhe përtej oazës së gjelbëruar ekzistuese - sipërfaqe prej **20.00m²**, me afat të caktuar me këtë Pëlqim.

Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e rregullimit të tokës ndërtimore.


Kërkesës i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e Pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe shfrytëzim të hapsirës publike konform Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8, pika 8.8.5.- në vlerë prej **15.00 euro**.

Udhëzime Juridike : Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPH-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtit.

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës :
Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë:
Visar Kuçi

